



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:245716

Datë: 31.10.2024

Numri i dokumentit: 06381437

**Në ankesën e**

**AC-I-24-0606**

***Paditësi/Ankuesi***

**M G**, fshati D, Podujevë, i përfaqësuar përmes avokatit B I Prishtinë.

***kundër***

***E paditura***

**NSH, FAN "Zahir Pajaziti"** Podujevë (në likuidim), të cilën e përfaqëson,  
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakërishtë,  
Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Ilmi Bajrami gjyqtar, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2324 të datës 17 korrik 2024, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 31 tetor 2024, me shumicë votash lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. Ankesa e paditësit është pjesërisht e bazuar.**
- 2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-2234 të datës 17 korrik 2024, dhe Vendimi i AKP-së-Autoritetit të Likuidimit PRN046-0942 i datës 19 mars 2014.**

- 3. Obligohet AKP-ja që ti paguaj paditësit shumën prej 740.57 euro në emër të pagave të papaguara për periudhën nga muaji mars 2003 e deri në mars 2005, interesin ligjor prej 10% të borxhit kryesor, ose 74.05 euro, si dhe shpenzimet e përfaqësimit nga ana e Avokatit në shumën prej 208.00 euro, të cilat shuma do të paguhen sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj në procedurën e Likuidimit.**
- 4. Pjesa tjetër e Aktgjyimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-2234 të datës 17 korrik 2024, lidhur me pjesën e kërkesës për paga nga muaji janar 2002- e deri në shkurt 2003, vërtetohet.**
- 5. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Me datë 01 prill 2014, paditësi ka dorëzuar në DHPGJS një ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit PRN046-0942 të datës 19 mars 2014, me të cilin Autoriteti i Likuidimit, e kishte refuzuar kërkesën e tij për kompensimin pagave të papaguara, për periudhën janar 2002 – mars 2005, në shumë prej 2,420.00 euro, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Në ankesë paditësi e ka kundërshtuar Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, duke pohuar se kërkesa për paga nuk është parashkruar siç konstaton në mënyrë të gabuar Autoriteti i Likuidimit. Tutje në ankesë paditësi ka pohuar se në NSH ka punuar deri me 24 mars 2006, kur kjo ndërmarrje është privatizuar. Ai pohon se e ka pranuar Njoftimin nga ana e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 24 mars 2006, dhe duke u bazuar në këtë njoftim, pastaj ai pas fillimit të procedurave të likuidimit ka paraqit kërkesën tek Autoriteti i Likuidimit lidhur me kërkesën për paga të papaguara për periudhën janar 2002-mars 2005. Bashkë me këtë ankesë paditësi ka bashkangjitur Kopjen e autorizimit për përfaqësuesin, kopjen e vendimit të Autoritetit të Likuidimit, Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës, dhe një kopje të Listës për 20%.

Me datë 08 dhjetor 2016, AKP-ja ka dorëzuar në DHPGJS mbrojtjen në ankesë.

AKP-ja mbanë qëndrimin se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. AKP ka pohuar se paditësi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga Autoriteti i Likuidimit, andaj ankesa është e pabazuar. AKP-ja në mbrojtjen në ankesë ka propozuar që ankesa e paditësit të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i AKP-së, duke theksuar se kërkesa është e parashkruar, bazuar në nenin 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar. Tutje AKP-ja ka pohuar se paditësi kërkesën për paga të papaguara është dashur të parashtrojë në ndonjë gjykatë në afat prej 3 viteve, nga koha kur ndërmarrja e ka ndërprerë pagesën e tyre – nga muaji janar i vitit 2002.

Me datë 29 dhjetor 2016, paditësi e dorëzon një parashtresë në DHPGJS dhe përgjigjet në mbrojtje në ankesë të AKP-së. Në këtë parashtresë paditësi i kundërshton pretendimet e AKP-së se kërkesa për paga është parashkruar.

Me datë 17 janar 2017, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS kundërpërgjigjen në të cilën ajo i përsëritë pretendimet e veta të cekura në mbrojtje në ankesë. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Me datë 08 dhjetor 2023, shkalla e I-rë e DHPGJS-së lëshoi një Urdhër për paditësin me të cilën kërkoi të dorëzoi prova shtesë në mbështetje të ankesës.

Me datë 18 dhjetor 2023, si përgjigje ndaj Urdhrit të shkallës së I-rë, paditësi e dorëzon edhe një parashtresë në DHPGJS, dhe bashkë me parashtresë dorëzon Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe kopjen e Librezës së punës.

Me datë 17 korrik 2024, Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, ma Aktgjykimin C-IV-14-2234, e refuzoi ankesën e paditësit si të pa bazuar dhe e vërtetoi vendimin e Autoritetit të Likuidimit PRN046-0942 të datës 19 mars 2014 si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se nuk ka dorëzuar asnjë provë se ndonjëherë i është drejtuar ndonjë gjykatë kompetente me padi lidhur me këtë çështje, gjegjësisht 3 vite pasi NSH-ja ka ndërprerë pagesën e të ardhurave personale të tij. Tutje shkalla e I-rë konstaton se paditësi ka dështuar të dorëzoj

prova për të vërtetuar se NSH-ja i ka mbetur borxh për pagat e kërkuara nga janari 2002- e deri në mars 2005, si dhe nuk ka dorëzuar prova për mënyrën e përlogaritjes së pagave të kërkuara, andaj nuk ka prova të mjaftuara në mbështetje të ankesës.

Me datë 06 gusht 2024, paditësi e dorëzon në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjykimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS-së C-IV-14-2234 të datës 17 korrik 2024, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave të së drejtës materiale, dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e tij si e bazuar, të ndryshohet Aktgjykimi i ankimuar, të anulohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN046-0942 i datës 19 mars 2014, të aprovohet padia si e bazuar dhe të detyrohet NSH-ja e paditur t'ia paguaj paditësit shumën prej 1,259.98 euro në emër të pagave të pa paguara, si dhe kamatën në bazë të nenit 382.2 të LMD-së, prej datës të pranimit të borxhit me 24 mars 2006 e deri në përmbushjen përfundimtare, si dhe ka kërkuar shpenzimet e përfaqësimit në shumë prej 416 euro, sipas tarifës së Odës së Avokatëve. Për më tepër në ankesë paditësi ka pohuar se me datë 01 prill 2014, e ka dorëzuar një ankesë ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit për të obliguar të paditurën t'ia kompensojë pagat e pa paguara në shume prej 1,259.98 euro, mirëpo nga gjykata nuk është marrë fare mbrojtja e AKP-së dhe nuk kemi mundur të bëjmë ndonjë përgjigje. Tutje paditësi pohon se në muajin mars të vitit 2006, mbi 345 punëtorë të "FAN" në Podujevë, i kanë pranuar letër pezullimet nga puna. Paditësi pohon se kërkesa për paga nuk është parashkruar siç pretendon e paditura, pasi që ai ka pranuar Njoftimin zyrtar për ndërprerje të marrëdhënies së punës në të cilën ceket se "shumat e pagave që u janë mbetur borxh sipas Kontratës suaj të punësimit do të mbesin në përgjegjësin e punëdhënësit, ndërsa kërkesat do të shqyrtohen sipas procedurave të likuidimit dhe ju do të kontaktoheni kur të fillojnë këto procedura". Tutje paditësi në ankesën e tij i referohet disa rasteve të Kolegjit të Apelit, të marra nga jurisprudenca e tij, si arsye që kërkesa e tij për paga ka bazë ligjore të aprovohet.

Me datë 26 gusht 2024, AKP-ja e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet ankesës paditësit. Në këtë parashtresë AKP-ja e kundërshton ankesën e paditësit si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje AKP-ja ka pohuar se në mbrojtjen në padi dhe në kundërpërgjigje ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e

ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. AKP-ja po ashtu ka pohuar se kërkesa e paditësit është parashkruar.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa është pjesërisht e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

### **Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit**

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor, andaj ai duhet pjesërisht të ndryshohet.

Kolegji i Apelit vëren se Autoriteti i Likuidimit pran AKP-së e ka refuzuar si të pa pavlefshme, kërkesën e paditësit për pagesën e pagave të papaguara për periudhën janar 2002-mars 2005 në shumë prej 2,420.00 euro nga NSH-ja "FAN" Zahir Pajaziti" në Likuidim, me arsyetimin se kërkesa e paditësit për paga është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Kolegji i Apelit ka vërejtur që Shkalla e I-rë e DHPGJS-së, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Vendimit të ankimuar Autoritetit të Likuidimit, e ka refuzuar si të pa bazuar dhe e ka vërtetuar Vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit si të drejtë dhe të bazuar në ligj, me arsyetimin se paditësi ka dështuar të dorëzojë prova për të vërtetuar se NSH-ja i ka mbetur borxh për pagat e kërkuara nga janari 2002- e deri në mars 2005, si dhe nuk ka dorëzuar prova për mënyrën e përlogaritjes së pagave të kërkuara, andaj nuk ka prova të mjaftuara në mbështetje të ankesës.

Kolegji i Apelit duke u bazuar në provat që ekzistojnë në dosje dhe ato të sjella gjatë procedurës ankimore, nuk pajtohet me konstatimin e Autoritetit të Likuidimit dhe as me konstatimin e Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, se ankuesi nuk ka sjellë prova për të dëshmuar se ai ishte punëtorë i NSH-së dhe në listën e pagave deri në

ditën e privatizimit të NSH-së, apo se kërkesa e tij për paga është parashkruar. Ky konstatim i gabuar i gjykatës së shkallës së parë dhe i Autoritetit të Likuidimit nuk mbështetet me provat që i ka sjellë ankuesi në gjykatë.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi në procedurën pranë Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, ka sjellë kopjen e autorizimit për përfaqësuesin, kopjen e vendimit të Autoritetit të Likuidimit, Njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies së punës, kopjen e Librezës së punës e mbyllur me 24 mars 2006 dhe një kopje të Listës për 20%.

Paditësi gjatë procedurës ankimore në shkallë të dytë ka sjellë edhe Listën e pagave të papaguara për periudhën janar 2002 e deri në mars 2005, e cila provë në interes të drejtësisë në bazë të nenit 70 të LDHP-së pranohet nga Kolegji i Apelit.

Këto dëshmi të ofruara nga paditësi nuk ka mundësi të injorohen dhe të mos merren parasysh. Paditësi me këto dëshmi ka vërtetuar faktin se ai ishte punëtorë i NSH-së deri në ditën kur NSH-ja është shitur në bazë të vendimit të Bordit të ish AKM-së. Lista e pagave për muajt e periudhës së cekur të hartuara nga menaxhmenti i NSH-së i për këtë paditësi.

Prandaj duke u bazuar në këto prova, Kolegji i Apeli vjen në përfundim se paditësi ka të drejtë ti paguhen pagat e pa paguara për muajt mars 2003, janar, shkurt, mars dhjetor 2004, si dhe janar, shkurt mars 2005, në shumë prej 740.57 euro, për të cilën periudhë nuk ka parashkrim të kërkesës. Njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 24 mars 2006, siç ka konstatuar shumë herë Kolegji i Apelit në jurisprudencën e tij, e ka ndërprerë parashkrimin për këtë periudhë të kërkesës për paga.

Ndërsa pagat e kërkuara nga muaji janar 2002 e deri në shkurt 2003 janë parashkruar, dhe për këtë pjesë të kërkesës për paga, vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së I-rë, pasi që paditësi nuk ka dorëzuar prova që vërtetojnë se është ndërprerë rrjedha e parashkrimit, për këtë periudhë kohore.

Kolegji i Apelit në bazë të nenit 37.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së paditësit ja njehë edhe interesin ligjor prej 10 të shumës së borxhit kryesor, në shumë prej 74.05 euro.

Kolegji i Apelit në bazë të nenit 62.2 të LDHP-së e pranon kërkesën e paditësi si palë e suksesshme, që të detyrohet e paditura ti kompensojë shpenzimet e përfaqësimit të avokatit të tij në shume prej 208 euro pasi që është e qartë se paditësi ishte i përfaqësuar nga avokati, dhe ai ka të drejt ti kompensohen edhe këto shpenzime lidhur me përfaqësimin e tij.

Andaj duke u bazuar në këto arsye, rezultati i dhënë ne Aktgjykimin e ankimuar nuk ka mundur të pranohet nga Kolegji i Apelit, prandaj është aprovuar pjesërisht ankesa e paditësit si e bazuar, është ndryshuar Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së I-rë të DHPGJS-së, si dhe vendimi i ankimuar i Autoritetit të Likuidimit, dhe është aprovuar pjesërisht padia e paditësit si e bazuar.

Nga këto arsye, e në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

### **Taksat gjyqësore**

Ankuesi në bazë të nenit 13.9 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/88 të datës 22.03.2017, i zbatueshëm nga data 1 maj 2017, është i liruar nga pagesa e taksës gjyqësore për procedurën ankimore, pasi që vlera e kontestit është më pak se 1000 euro.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 31 tetor 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues \_\_\_\_\_